



SHKOLLA PRIVATE E ARSIMIT TË LARTË "PAVARËSIA", VLORË

Tel: +355 33 4 11 555

Tel: +355 33 4 11 666

Fax: +355 33 4 11 777

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Shkolla Private e Arsimit të Lartë "Pavaresia"

Rregullore

"Njesia e brendshme e sigurimit të cilësisë"



PJESA E PARË

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Me dispozitat e kësaj Rregulloreje përcaktohen procedurat dhe metodat e sigurimit të cilësisë në nivel institucional dhe programesh studimi në përputhje me standartet shtetërore të cilësisë dhe standartet e udhëzimet përkatëse të cilësisë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë dhe atë ndërkombëtare të arsimit të lartë, si dhe të vlerësimit të cilësisë së punës të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor e shërbime të tjera në SHPAL Pavaresia.

Neni 2

Misioni i vlerësimit të brendshëm të cilësisë

Misioni NJBSC nga SHPAL Pavaresia", se çfarë kuadri do të përgatisë, plotësimin e nevojave kryesore të shoqërisë, përshtatja e tyre në vend dhe jashtë, si dhe i përcakton drejtimet e veprimtarisë kërkimore-shkencore.

Neni 3

Vlerësimi, si hap i parë në procesin e vlerësimit të cilësisë, ka këto qëllime kryesore:

- 3.1 Të paraqesë një përmbledhje të të dhënave mbi procesin mësimor dhe mbi programet e studimit të institucionit, sipas treguesve të caktuara në raport me standartet ekzistuese, vendase apo ndërkombëtare;
- 3.2 Të vlerësojë koordinimin e procesit mësimor-arsimor dhe veprimtarisë kërkimore-shkencore të institucionit;
- 3.3 Të analizojë strukturën, cilësinë dhe ngritjen akademike të stafit;
- 3.4 Të analizojë anët e mira dhe të dobëta të universitetit në tërësi dhe të fakulteteve në veçanti;
- 3.5 Të sigurojë mjetet e nevojshme, që do të shërbejë për kryerjen e vlerësimit;



3.6 Të sigurojë zgjerimin dhe rifreskimin bazës të të dhënave të analizuara paraprakisht, e cila do të shërbejë për kryerjen e vlerësimit të jashtëm nga ekspertë dhe konsulentë, vendas apo të huaj;

Neni 4

Fusha e veprimit

Me këtë Rregullore përcaktohet sigurimi dhe vlerësimi i brendshëm i cilësisë në këto fusha:

- 2.1 Strukturat organizative për sigurimin e cilësisë;
- 2.2 Subjektet e sigurimit të cilësisë
- 2.3 Programet studimore;
- 2.4 Proçesi i kontrollit të dijeve;
- 2.5 Efikasiteti i veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe praktikat profesionale;
- 2.6 Burimet njerëzore (stafi akademik dhe ndihmës akademik);
- 2.7 Studentët;
- 2.8 Diplomimi;
- 2.9 Tekstet, literatura, biblioteka dhe labororet në universitet;
- 2.10 Përkrahja jo arsimore;
- 2.11 Ambienti (hapësira arsimore) dhe pajisjet;
- 2.12 Veprimtaria administrative dhe financiare;
- 2.13 Përfshirja e studentëve në proçesin e vlerësimit dhe ekspertë të jashtëm.

Neni 5

SHPAL Pavaresia", e realizon vlerësimin e programeve të studimit në të gjitha ciklet dhe format që ofron ky universitet. Me vlerësim e programeve të studimit, përmes proçedurave të qarta bëhet vlerësimi i cilësisë të veprimtarisë mësimore dhe të kërkimit shkencor.

Me vlerësimin e programit studimor duhet të përcaktohet se a i përgjigjet ai standardeve shtetërore të cilësisë të propozuara nga Këshilli i Arsimit të Lartë, në bashkpunim me Agjencinë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë, mbështetur dhe në udhëzimet e Sigurimit të Cilësisë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë.

Neni 6

Përcaktimi për vlerësimin e cilësisë së brendshme të mësimdhënies në SHPAL Pavaresia realizohet nëpërmjet elementëve vijuese:



- 5.1 Miratimin e Politikës për rekrutimin e personelit, të NJBSC, e cila është pjesë e administratës së SHPAL Pavaresia dhe subjekti i kërkimit periodik;
- 5.2 Ndërtimin e sistemit për vlerësimin e cilësisë së brendshme, duke përfshirë në mes të tjerave edhe krijimin e strukturave përgjegjëse, standardeve dhe parimeve, si dhe për përcaktimin e qartë të roleve të të gjithë subjekteve në këtë proces;
- 5.3 Planifikimin e aktiviteteve në fushat dhe aspektet me rëndësi të madhe për sigurimin e cilësisë të mësimdhënies, e veçanërisht lidhur me procesin mësimor, punën shkencore-hulumtuese, studimet më efikase dhe resurseve financiare;
- 5.4 Përcjelljen e vazhdueshme dhe grumbullimi sistematik i të dhënave për sigurimin e kualitetit, nëpërmes të organizimit dhe krahasimit të kërkimeve periodike në të gjitha fushat e aktivitetit dhe krahasimi i rezultateve të fituara me planifikimin e bërë;
- 5.5 Organizimin dhe krahasimin e kërkimeve periodike në përputhje me standartet dhe procedurat për sigurimin e cilësisë, me qëllim përmbushjen e objektivave.

Neni 7

Subjektet e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë

Subjektet e sigurimit të cilësisë dhe të vlerësimit në SHPAL Pavaresia janë: stafi akademik, stafi ndihmës mësimor-shkencor, stafi joakademik, studentët dhe stafi administrativ. Me këtë Rregullore përcaktohen funksionet themelore dhe marrëdhëniet reciproke të të gjithë subjekteve në procesin vlerësimit të cilësisë.

PJESA E DYTË

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I NJBSC

Neni 8

Përbërja e NJBSC

NJBSC organ kompetent, që ngrihet me urdher të Rektorit dhe drejtohet nga kryetari, i cili bën raportimin të vazhdueshëm dhe sistematik, si dhe grumbullimin e të dhënave rreth cilësisë, nëpërmjet organizimit të kërkimit periodik në të gjitha fushat e sigurimit të cilësisë, me qëllim të sigurimit dhe vlerësimit të cilësisë të punës në universitet. Kjo degë përbëhet nga: Kryetari; nje perfaqesues nga cdo fakultet; nje perfaqesues nga unioni studentor dhe nje perfaqesues nga personeli joakademik.

Neni 9



NJBSC ka autonomi operative dhe akses për të gjitha të dhënat e institucionit.

Neni 10

Me procesin e vlerësimit të cilësisë nënkuptojnë aplikimin e vlerësimit të rregullt dhe të veçantë. NJBSC përgatit planet për implementimin e të gjitha aspekteve të vlerësimit, duke përfshirë fushat e kërkimit, angazhimin e subjekteve dhe planin e punës si dhe i raporton Rektorit, për rezultatet e treguara të vlerësimit, me propozime konkrete për marrjen e masave të nevojshme, nëse kjo është e domosdoshme. Procesi i vlerësimit krijohet në bazë të analizave të dokumenteve dhe informacioneve të rëndësishme, krahasimit të planit të veprimit si dhe në grumbullimin e qëndrimeve dhe të dhënave të subjekteve në degën e vlerësimit të cilësisë nëpërmjet anketimit.

Neni 11

Anketimi

1.Kontrolli i cilësisë së mësimdhënies realizohet nëpërmjet anketimit. Formulari i Anketimit hartohet nga kjo degë në bashkpunim me njësitë kryesore dhe ato bazë sipas modaliteteve të përcaktuara prej tyre, më pas miratohet nga Rektori.

2.Procesi i Anketimit zhvillohet në mënyrë periodike dhe realizohet nga Teknologjisë së Informacionit dhe Regjistrimeve sipas modaliteteve të përcaktuara nga NJBSC

3. Teknologjisë së Informacionit dhe Regjistrimeve Brenda 15 ditëve dërgon rezultatet e anketimit tek NJBSC, e cila brenda 10 ditëve harton raportin e vlerësimit përfundimtar të anketimit dhe e përcjell atë në Rektori.

Neni 12

Kjo njesi vlerëson si aspektet funksionale, ashtu edhe ato të programeve që institucioni ofron. Gjatë këtij procesi vlerësohet gjithashtu shkalla e përputhje ndërmjet objektivave, nivelit dhe kompetencave profesionale të synuara të programit të studimit dhe kurrikulës së ofruar, si dhe respektimin e rekomandimeve të akteve ligjore e nënligjore në fuqi, për hartimin e planeve mësimore e programeve të disiplinave të ndryshme.

Neni 13



NJBSC përgatit raportin me rezultatet e vlerësimit dhe ia dërgon Rektorit, i cili e vlerëson cilësinë e punës në sektorë të caktuar të SHPAL Pavaresia, me propozime e masa për heqjen e pengesave në ngritjen e cilësisë të punës.

Neni 14

Struktura organizative te Rrjetit te Vlerësimit

NJBSC duhet te jete përgjegjës për realizimin e brendeshem te cilësisë në të gjitha njesite perberese organizative. Për këtë duhet te ngrihet rrjeti i cilësisë me përgjegjësinë e ngritjes, implementimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në SHPAL Pavaresia, mbështetur në standardet shtetërore të cilësisë si dhe standardet dhe udhëzimet europiane për Sigurimin e Cilësisë në Hapsirën Evropiane të Arsimit tëLartë.

Senati i SHPAL Pavaresia miraton te gjithë dokumentacionin per sistemin e cilesise.

Neni 15

NJBSC

1. NJBSC duhet te planifikoje organizimin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë të programeve të studimit dhe të vlerësimit të brendshëm institucional.
2. Për të realizuar këtë duhet te ngrihet grupi i punës i vlerësimit të brendshëm, ku merr pjesë edhe një përfaqësues të njësive kryesore, të këshillit të studentëve, Teknologjisë së Informacionit dhe Regjistrimeve. Në rast nevojë, ftohet një përfaqësues ekspert i jashtëm I propozuar nga APAAL.
3. Vlerësimi i brendshëm realizohet në përputhje me udhëzimet përkatëse të APAAL.
4. Konkluzionet e vlerësimit të brendshëm duhet te mbështeten në analizën statistikore të të dhënave, në konstatimet e nxjerra nga regjistrat, në sondazhet, pyetsorët dhe intervistat e organizuar me stafin akademik, stafin joakademik dhe studentët. Drejtuesit e njësive të vlerësuara duhet te publikojnë rezultatet e vlerësimit të kryer.
5. Jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i semestrit, NJBSC i paraqet Rektorit raportin e vlerësimit semestral.
6. Vlerësimi i brendshëm i programeve të studimit apo institucional duhet te organizohet si rregull një here në vit. Nëse është e nevojshme, njësia mund të organizojë vlerësime të pjesshme edhe më shpesh.



7. Mënyra e organizimit të vlerësimit të brendshëm, aktivitetet që kryhen, përgjegjësitë dhe mënyra e paraqitjes së rezultateve duhet të përcaktohen në rregulloret dhe procedurat përkatëse.
8. NJBSC, duhet të ketë përgjegjësinë e sigurimit të burimeve të nevojshme financiare për mbulimin e gjithë aktiviteteve të procesit të vlerësimit të brendshëm.
9. NJBSC duhet të mbaje lidhje të vazhdueshme me Agjensinë Publike të Akreditimit të Arsimit të lartë për realizimin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë dhe vlerësimin e jashtëm.
10. Kjo degë ka detyrimin të marrë pjesë në trajnim të organizuar nga APAAL, si dhe të organizoj trajnim për vlerësim e brendshëm, për pjesëmarrësit e tjerë në procesin e vlerësimit të cilësisë.
11. NJBSC duhet të marrë rekomandime mbi kriteret, metodat dhe indikatorët e përgjithshëm (të cilat janë bërë publike para fillimit të vlerësimit të brendshëm), si dhe kriteret e metodat e përshtatshme për vlerësimin periodik të sistemit nga APAAL.
12. NJBSC brenda 10 ditëve harton raportin e vlerësimit përfundimtar të anketimit dhe e përcjell atë tek Rektori.

Neni 16

Të drejtat e Kryetarit të Njesia e Brendshme e sigurimit te cilesise

1. Përveç sa përcaktohet në Kodin e Punës dhe në kontratën individuale të punës Kryetari i NJBSC te sigurimit ka këto të drejta:
 - a) Të shfrytëzojë të gjitha mundësitë që ofron institucioni, duke respektuar të gjitha rregullat e vendosura;
 - b) Të kërkojë të respektohen dhe të zbatohen të gjitha detyrimet që shtrohen gjatë realizimit të detyrës së ngarkuar;
 - c) Të kërkojë nga autoritet dhe organet drejtuese të universitetit, respektimin prej tyre të të gjitha të drejtave që burojnë nga Kodi i punës dhe Ligji për Arsimin e Lartë;
 - d) Të kërkojë nga kolegët një frymë etiko-morale të tillë, që të jetë në pajtim me legjislacionin në fuqi;

Kryetari ka këto detyrime:

- a) Të respektojë gjatë gjithë veprimtarisë së tij parimet e etikës qytetare, Kodin e Etikës të SHLP duke shfaqur një figure të pajtueshme me veprimtarinë që zhvillohet në universitet;
- b) Të kryejë me përgjegjësi detyrën e ngarkuar duke vënë në shërbim aftësitë profesionale dhe intelektuale;
- c) Të respektojë me përgjegjësi disiplinën në punë;
- d) Të ruajë bazën material që ka në ngarkim;



- e) Të ruajë sekretin profesional, të mos japë të dhëna lidhur me detyrën që kryen pa qenë I autorizuar nga autoriteti drejtues përkatës;
- f) Të zbatojë udhëzimet që dalin si domosdoshmëri gjatë realizimit të detyrës së ngarkuar;
- g) Të realizojë detyra në zbatim me aktet ligjore e nënligjore në fuqi apo urdhrave të drejtuesit përkatës;
- h) Planifikon, organizon dhe koordinon punën e degës dhe grupeve të punë nënjësitë kryesore;
- i) Përkujdeset që të mundësoj diskutim të gjerë për vlerësim ebrendshëm të cilësisë, me qëllim krijimin e një raporti të pranueshëm tërësisht për vlerësim e cilësisë;
- j) Realizon komunikim zyrtar e organet e SHPAL Pavaresia, si dhe me organin e vlerësimit në APAAL;
- k) Merr pjesë në veprimtaritë që lidhen me projektet shkencore në SHPAL Pavaresia;
- l) Kryen përpunimin administrative të dosjeve të titujve akademikë;
- m) Merr pjesë në përpilimin e projekt-dokumentacionit për diplomat e të tre cikleve;
- n) Kryen përgatitjen e dokumentacionit për Mbledhjet e Senatit të SHPAL Pavaresia, që lidhen me kurrikulat;
- o) Kryen veprimtari operative që lidhet me të tre ciklet për sistemin me kohë të plotë dhe atë të pjesshëm;
- p) Kryen veprimtari që lidhet me Maturën shtetërore;
- q) Kryen veprimtari që lidhet me transferimet në SHPAL Pavaresia;
- r) Kryen përpunimin e projekt-politikave të kuotave dhe të indekseve të lëndëve me zgjedhje për mature shtetërore;
- s) Kryen punë të tjera në lidhje me realizimin e vlerësimit të cilësisë së brendshme.

Neni 17

Të drejtat dhe detyrimet e anetareve te NJBSC

Anetaret e NJBSC kanë të drejta dhe detyrime të njëjta si kryetari i NJBSC. Duhet që aktivisht të marr/in pjesë në punën e komisioneve të ngritura në njësitë e universitetit, sa më gjerësisht që është e mundur të realizojnë kontakte dhe të prezantojnë mendimet e anëtarëve të bashkësisë akademike, si dhe të jenë në gjendje ti vlerësojnë anët e dobëta dhe të forta të funksionimit të SHPAL Pavaresia.

Neni 18

Grupet e Punës



NJSBC në SHPAL Pavaresia, mund të formoj grupet e veta punuese me përfaqësues të njësive kryesore, të këshillit të studentëve, Teknologjisë së Informacionit dhe Regjistrimeve të cilëve mund ti besohen punë dhe çështje të caktuara specifike, siç janë: vlerësimi i programeve të caktuara studimore, kontrolli i burimeve dhe financave, trajnimi i stafit akademik/joakademik dhe stafit ndihmës mësimor-kërkimor dhe ngritja e tyre, shërbimet e studentëve, bashkëpunimi i jashtëm, aktivitetet ndërkombëtare e të ngjashme.

Neni 19

1. Fakulteti duhet te organizoje në fund të çdo viti akademik vlerësimin periodik të programit të studimit dhe rregullores mësimore të tij.

2. Dekani i fakultetit duhet te aktivizojë grupin e punës për vlerësimi e brendshëm të cilësisë, i cili duhet të jetë përgjegjës për këtë proces.

Neni 20

Detyrat e Grupeve të Punës te NJSBC

Gjatë këtij vlerësimi vëmendje duhet t'i kushtohet:

1. Vlerësimi të shpërndarjes së krediteve për disipinat apo grup - disipinat përkatëse;
2. Vlerësimi të programeve mësimore të lëndëve të veçanta;
3. Vlerësimi të elementëve përbërës të disipinave dhe ndarjen e krediteve ndërmjet tyre (leksione, seminare, detyra, projekte, laboratorë, etj.);
4. Vlerësimi i rregullores së programit të studimit;
5. Vlerësimi i bazës së nevojshme didaktike për realizimin e programit të studimit, evidentimi i mangësive dhe marrja e masave për vitin pasardhës;
6. Vlerësimi i literaturës së përdorur, mungesat e vërejtura dhe masat për përmirësimin e situatës;
7. Vlerësimi i implementimit të programit të studimit në vitin përkatës akademik;
8. Vlerësimi i procedurave të kontrollit të dijeve/provimeve dhe analiza e rezultateve të kontrollit;
9. Vlerësimi i feedback-ut të marrë nga studenti.
10. Grupeve te Vlersimit te Brendshem ne Fakultete duhet të raportojnë në mënyrë periodike, si dhe sa here te kërkohen informacione apo të dhëna të tjera nga NJSBC.

PJESA E TRETË

PLANIFIKIMI

Neni 21



Me qëllim të realizimit të misionit, SHPAL Pavaresia për çdo vit akademik, planifikon të gjitha aktivitetet me rëndësi për sigurimin e cilësisë. Propozim Plani i Veprimit për vitin akademik e përgatit Kryetari i NJBSC para fillimit të vitit të ri akademik dhe ia dërgon Rektoratit për miratim.

Plani i punës për vitin akademik përmban fushat vijuese:

1. Proçesi arsimor: numri i nevojshëm i profesorëve dhe bashkëpunëtorëve, planet e punës dhe planet operative për çdo lëndë;
2. Studentët: numri i studentëve sipas viteve, udhezime dhe treguesë për studime të suksesshme;
3. Puna kërkimore-shkencore dhe arsimore si dhe veprimtaria botuese, planifikimi i projekteve dhe i publikimeve;
4. Biblioteka: sigurimin e botimeve të reja;
5. Hapësira dhe pajisjet: të nevojshme pajisjet themelore për punë;
6. Vlerësimi i cilësisë së brendshme (ashtu siç është përcaktuar në këtë Rregullore)

Neni 22

Vlerësimi i Cilësisë të Programeve të Studimit

Cilësia e programeve studimore realizohet nëpërmjet krijimit dhe përgatitjes së standardeve të posaçme dhe modaliteteve të përshtatshëm, me qëllim të:

1. Realizimit të misionit dhe vizionit në SHPAL Pavaresia
2. Realizimit të qëllimeve të programeve studimore;
3. Zhvillimit dhe efikasitetit të studimeve;
4. Modernizimin e përmbajtjes së programeve studimore;
5. Grumbullimin e vazhdueshëm të informacioneve nga subjektet për sigurimin e cilësisë, lidhur me vlerësimin e cilësisë të programeve studimore.

Neni 23

NJBSC, shqyrton cilësinë e programeve studimore, sipas udhëzimeve për plotësimin e standardeve e veçanërisht në:

1. Hartimin e Programeve studimore në bazë të arritjeve më të reja me aftësi konkurruese në treg;
2. Pajtueshmëria me nevojat e përparuara të shoqërisë, në bazë të grumbullimit të informacioneve të përshtatshme nga institucionet e specializuara;



3. Krahasimi me programet e huaja studimore, prej të cilave më së paku dy duhet të jenë nga hapësira evropiane e arsimit në secilin program studimor, në bazë të grumbullimit të informacioneve të përshtatshme nga institucionet e huaja.

Neni 24

NJBSC shqyrton efikasitetin e studimeve sipas programeve ekzistuese të studimeve, në bazë të dhënave të cilat i grumbullon nga Sekretaritet Mësimore të Fakulteteve Përkatëse. Ky efikasiteti studimesh mund të matet sipas dhënave vijuese:

1. përqindja e kalueshmërisë së studentëve nga një vit në tjetrin;
2. mesatarja e notave sipas viteve të studimit;
3. numri i studentëve të diplomuar;
4. mesatarja e notave të studentëve të diplomuar në të gjitha nivelet e studimeve;
5. pjesëmarrja e studentëve të diplomuar në krahasim me numrin e studentëve të regjistruar në çdo program studimor;
6. mesatarja e kohës së studimeve për çdo program studimor.

Neni 25

Vlerësimi i Cilësisë së Proçesit Mësimor

Vlerësimi i cilësisë së proçesit mësimor sigurohet nëpërmjet:

1. Organizimit, përgatitjes dhe ndarjes së proçesit mësimor në atë mënyrë që studenti:
 - a) Të zhvillojë aftësitë komunikuese dhe interaktive;
 - b) Të aplikojë koncepte teorike themelore;
 - c) Të zhvillojë aftësitë të cilat do ti mundësojnë studentit që pavarësisht se mund të punojë por dhe të arrijë të kërkojë njohuri të reja;
 - d) Të ketë përgjegjshmërinë nëse është anëtar në një ekip;
 - e) Të zhvillojë aftësitë e mendimit dhe të zgjidhjes së problemeve;
 - f) Të zhvillojë aftësitë e integritit të njohurive.
2. Sigurimin e cilësisë të stafit akademik dhe joakademik, veçanërisht sigurimin e raporteve profesionale në punë me studentë dhe sigurimin e kushteve të përshtatshme për punën kërkimore-shkencore dhe përsosshmërinë të mësimdhënies;
3. Sigurimin e numrit të nevojshëm të lektorëve të brendshëm dhe të ftuar e veçanërisht atyre me kohë të plotë të punës si dhe krijimin e kushteve për zhvillimin e qetë të leksioneve, në nivelin e planifikuar.
4. Sigurimin e kualitetit të fondit të librave në bibliotekë si dhe të gjithë hapësirës së mjaftueshme në të;



Neni 26

Me qëllim të sigurimit të cilësisë së brendshme, teknikat e organizimit dhe përgatitjes së procesit mësimor përfshijnë përcaktimin para fillimit të semestrit të planit mësimor, (leksionet dhe seminarët) planit të punës për çdo lëndë që është në atë semestër si dhe plani i organizimit të provimeve. Plane të tilla duhet t'i prezantohen studentëve në forma të ndryshme, të paktën ditën e parë të fillimit të semestrit, me përjashtim të planit për organizimin e provimeve, i cili mund të përgatitet jo më pak se ----- ditë para fillimit të afatit të provimeve.

Neni 27

Planin për zhvillimin e procesit mësimor si dhe planin për organizimin e provimeve e përgatisin Dekanët e Fakulteteve të SHPAL Pavaresia, duke marrë parasysh mundësitë dhe kërkesat e studentëve, ngarkesën sipas lëndëve, shfrytëzimin efikas të mjediseve së godinës dhe faktorët e tjerë. Sekretariteti Mësimor duhet të jenë korrekt në vendosjen e planit për zhvillimin e procesit mësimor dhe të orareve të leksioneve e të provimeve në stendat e shpalljeve si dhe në faqen elektronike zyrtare të SHPAL Pavaresia.

Neni 28

NJBSC në procesin e vlerësimit të rregullt, nëpërmjet anketimit, grumbullon qëndrimet dhe të dhënat për lektorët e brendshëm dhe ata të ftuar, në aspektet vijuese të vlerësimit të procesit mësimor:

1. sigurimi i informacioneve të rëndësishme për procesin mësimor;
2. mbajtjen e leksioneve, provimeve, në përputhje me planin e miratuar;
3. mbajtjen e raporteve profesionale të stafit akademik dhe stafit jo akademik në raport me studentët;
4. mundësive të arritjes së aftësive dhe të njohurive të mjaftueshme gjatë procesit mësimor në lëndët e caktuara, në përputhje me planin.

Lidhur me këtë, NJBSC përgatit një raport për anketimin e zhvilluar, të cilin ia dorëzon Rektorit..

Neni 29

Vlerësimi i Punës Mësimore dhe Kërkimore-Shkencore



Me qëllim të sigurimit të cilësisë të punës kërkimore-shkencore dhe arsimore, si dhe me qëllim të sigurimit të cilësisë së punës në universitet, organet kompetente të SHPAL Pavaresia, si edhe të gjithë stafi akademik, pandërprerë angazhohen në krijimin, përgatitjen dhe realizimin e programit arsimor, shkencor dhe projektet kërkimore, në përputhje me:

1. Strategjinë dhe Politikën e SHPAL Pavaresia;
2. Nevojat dhe pritshmëritë e shoqërisë;
3. Praktikën më të mirë të institucioneve të huaja arsimore, dhe kërkimore-shkencore;
4. Nevojat për sigurimin e cilësisë në fushat e tjera të SHPAL Pavaresia në të cilat kjo Rregullore është e zbatueshme;
5. Disponimin e burimeve të brendshme dhe të jashtme për realizimin e programeve dhe projekteve konform standarteve.

Neni 30

Veprimtaria kërkimore-shkencore vlerësohen sipas:

1. numrit të publikimeve në __5__ vitet e fundit;
2. numrit të citimeve nga autorët e huaj (të dhëna nga bazat e citimeve);
3. numrit të përgjithshëm të projekteve të paraqitura në __5__ vitet e fundit (kombëtare dhe ndërkombëtare);
4. numrit të përgjithshëm të projekteve të realizuara në __5__ vitet e fundit (kombëtare dhe ndërkombëtare);
5. pjesëmarrjes në seminare, konferenca, këshilla shkencor (kombëtare dhe ndërkombëtare) në _5_ vitet e fundit);
6. numrit të përgjithshëm të mbledhjeve shkencore të organizuara në _5_ vitet e fundit nga ana e SHPAL Pavaresia.

Neni 31

Vlerësimi i Cilësisë të Stafit Akademik

Vlerësimi i cilësisë të stafit akademik realizohet me anë të aktiviteteve të përshtatshme dhe të vazhdueshme, si në vijim:

1. planifikimit të vazhdueshëm dhe paraqitja e nevojave për angazhimin e stafit akademik në fushat e ndryshme kërkimore-shkencore dhe arsimore;
2. përzgjedhja e stafit akademik sipas Statutit dhe Rregullores për Rregullat dhe Proçedurat e Punësimit për Stafin e SHPAL Pavaresia, duke i përcaktuar paraprakisht kriteret dhe udhëzimet;
3. krijimin e kushteve për përsosmërinë e vazhdueshme arsimore dhe shkencore të stafit akademik;



4. paraqitjen objektive dhe korrekte të vlerësimit të cilësisë në këtë fushë, ashtu siç është e pare dhe më parë në këtë Rregullore.

Neni 32

Kriteret për Vlerësimin e Cilësisë të Stafit Akademik

Zgjedhja e stafit akademik bëhet në përputhje me kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen me tituj shkencor, të përcaktuara me Statutin e SHPAL Pavaresia, respektivisht me Rregulloren e Kolegjit

Vlerësimi periodik i cilësisë të stafit akademik të SHPAL Pavaresia, bëhet nga ana e organit për vlerësimin e arsimit të lartë, sipas kësaj Rregulloreje:

1. Kualifikimeve të stafit akademik, në përputhje me aktet e përgjithshme të SHPAL Pavaresia;
2. Zbatimin në praktikë të kriterëve për përzgjedhjen në nivel të SHPAL Pavaresia;
3. Mbulimi i të gjitha fushave shkencore me staf akademik;
4. Realizimi i anketave të rregullta me studentët për cilësinë e stafit akademik dhe marrja parasysh e mendimit të tyre;
5. Realizimi i mekanizmit motivues dhe shpërblimeve nga ana e institucionit;
6. Organizimin e kurseve të detyrueshme për trajnim dhe zhvillim e stafit akademik.

Neni 33

Masat për Përmirësimin e Cilësisë

NjBSC, e cila kryen veprimtari bazuar në Ligjin e arsimit të lartë, Statutit dhe Rregullores së SHPAL Pavaresia, propozon dhe ndërmerr masa për përmirësimin cilësisë së punës të stafit akademik dhe jo akademik.

Neni 34

Vlerësimi i Cilësisë të Studentëve

Vlerësimi i cilësisë të studentëve, realizohet nëpërmjet aktiviteteve dhe standardeve në fushat vijuese:

1. selektimi e studentëve me rastin e regjistrimit të tyre;
2. procesit mësimor;



3. organizimit të studentëve;
4. përpunimin dhe analizimin në mënyrë të vazhdueshme dhe të rregullt për vlerësimin e cilësisë në këtë fushë në përputhje me këtë Rregullore.

Neni 35

Cilësia e Teksteve, Literaturës, Bibliotekës dhe Laboratoreve

Vlerësimi i cilësisë të teksteve, literaturës, bibliotekës dhe laboratoreve të ndryshme është i domosdoshëm në zhvillimin e suksesshëm të procesit arsimor dhe realizohet përmes:

1. sigurimit të teksteve shkollore të cilat mundësojnë realizimin e qëllimeve të përcaktuara sipas programit studimor dhe lëndëve;
2. sigurimin e fondit të mjaftueshëm të literaturës, fond i cili mundëson realizimin e qëllimeve të përcaktuara sipas programit studimor dhe lëndëve;
3. sigurimin e pajisjeve moderne në laboratoreve për zhvillimin e procesit mësimor dhe për nevojat e studentëve;
4. sigurimin e hapësirës së mjaftueshme për shfrytëzimin efikas të bibliotekës dhe të laboratoreve nga ana e studentëve dhe stafit akademik të SHPAL Pavaresia.

Neni 36

Dega e vlerësimit të cilësisë, në procesin e vlerësimit të rregullt, përmes anketimit grumbullon të dhënat dhe qëndrimet e studentëve, stafit akademik, në aspektet vijuese të cilësisë të teksteve, literaturës, bibliotekës dhe laboratoreve të ndryshme:

1. pajisja e mjaftueshme me tekste shkollore sipas standardeve akademike dhe
2. vlerësimi sipas ECTS kredive;
3. përmbajtja e teksteve shkollore me të dhëna të mjaftueshme, sipas kërkesa të studentëve gjatë marrjes së njohurive në lëndët e caktuara;
4. pajisja e mjaftueshme e bibliotekës me literaturë dhe tekste shkollore dhe vënia në dispozicion të këtij fondi të bibliotekës si dhe ambientet e saj në shërbim të studentëve.

Neni 37

Vlerësimi i Cilësisë së Hapësirës Mësimore dhe Pajisjeve

Vlerësimi i cilësisë të hapësirës arsimore dhe pajisjeve realizohet nëpërmjet:

1. sigurimit të hapësirës dhe pajisjeve të teknologjisë së re informative, për realizimin e qëllimeve të cilësisë të procesit arsimor, së paku në përputhje me standardet kombëtare dhe ato të hapësirës europiane;



2. sigurimin e pandërprerë të lidhjes së internetit dhe lënien në disponim për lektorët dhe studentët;
3. vlerësimin e vazhdueshëm të cilësisë të këtyre pajisjeve sipas numrit të studentëve si dhe sipas kërkesave për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, procesit arsimor dhe atij kërkimor-shkencor të SHPAL Pavaresia;
4. evidentimin e pajisjeve aktuale dhe parashikimin e nevojave për të ardhmen;
5. aplikimin e masave të përshtatshme për siguri, mbrojtje të shëndetit të punësuarave, studentëve dhe të gjithë personave të tjerë që janë për rreth tyre, në përputhje me ligjin.

PJESA E KATËRT

BASHKËPUNIMI I JASHTËM, KOMBËTAR, NDËRKOMBËTAR DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

Neni 38

Bashkëpunimi Kombëtar

Bashkëpunimi kombëtar vlerësohet sipas:

1. bashkëpunimit me qendra ndëruniversitare për zhvillim dhe promovim, në kontekst të misionit, qëllimeve dhe detyrave të universitetit;
2. numrit të përgjithshëm të projekteve në _5_ vitet e fundit;
3. kontakteve dhe bashkëpunimit me studentët e diplomuar dhe me shoqatat e tyre;
4. kontakteve me punëdhënësit.

Neni 39

Bashkëpunimi Ndërkombëtar

Bashkëpunimi ndërkombëtar vlerësohet sipas:

1. pjesëmarrjes në programe arsimore evropiane (Tempus, Erasmus, Mundus e të tjera në _5_ vitet e fundit);
2. karakteri ndërkombëtar i programeve të studimit;
3. shkëmbimit të stafit akademik me qendrat e tjera akademike në vend dhe jashtë;
4. shkëmbimi i studentëve me qendra tjera akademike në vend dhe jashtë;
5. zhvilli i mësimi edhe në gjuhë të huaja;
6. shfrytëzimi i literaturës së huaj.



Neni 40

Marrëdhëniet me Publikun

Marrëdhëniet me publikun vlerësohen sipas:

1. ditëve të hapura të universitetit për njohjen e studentëve potencialë me mundësitë për studim dhe kërkim në këtë universitet;
2. bashkëpunimit me mediat e shkruara dhe ato elektronike;
3. pjesëmarrja në panairë për arsimin.

PJESA E PESTË

RAPORTI I VLERËSIMIT

Neni 41

Përmbajtja e Raportit të Vlerësimit

NJBSC në SHPAL Pavaresia, pas realizimit të vlerësimit, përgatit raportin për vlerësim në mënyrë objektive, transparente dhe publike me përfshirjen e të gjitha mangësive. Gjatë përgatitjes së raportit, kjo degë duhet të ketë të qartë se në raport duhet të merren parasysh të gjitha faktet për programet studimore dhe programet e lëndëve. Ky raport përbëhet prej dy pjesëve: pjesës përshkuese dhe pjesës së treguesve të matshëm, me të gjitha të dhënat respektive sasiore:

1. hyrja, ku sqarohet procesi i vlerësimit;
2. lista e anëtarëve të degës dhe grupeve punuese të njësive cilët kanë marrë pjesë në vetëvlerësim;
3. lista e organeve, subjekteve dhe institucioneve me të cilët universiteti ka bashkëpunuar në vlerësim;
4. paraqitja e elementeve pozitivë dhe e vështirësive që janë paraqitur gjatë procesit të vlerësimit;
5. në pjesën për studentët aktualë dhe atyre të diplomuar, raporti duhet të përmbajë të dhënat, idetë, komentet dhe sugjerimet, të dhëna nga studentët për të gjitha aspektet e vlerësimit të cilësisë, me qëllim që të mund të ndihmojnë në përmirësimin e procesit të vlerësimit.

Nga pikëpamja praktike, ideja e studentëve mund të merret në disa mënyra: përmes diskutimeve të lira, bisedimeve interaktive, përmes anketave të ndryshme me studentë, takimeve me qeveritë studentore, ide në formë të shkruar, apo kombinime të ndryshme të propozimeve të lartpërmendura;



6. pjesa për studentët në raport duhet të paraqesë një tërësi të posaçme. Është shumë i rëndësishëm numri i studentëve të mos jetë selektiv, por ti përfaqësoj interesat e tyre në SHLP dhe në programin studimor në cilin ata studiojnë.

Pikë fillestare e analizës janë misioni dhe qëllimet e SHPAL Pavaresia, ku ato analizohen dhe vlerësohen. Analizat i ndriçojnë anët e forta dhe të dobëta të secilit component, që është objekt i vlerësimit. Analizat zhvillohen me propozime dhe me plan korrigjues të aktiviteteve për eliminimin e mangësive dhe për përmirësimin e kualitetit.

Neni 42

Përfundimi i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë

Përfundimi i raportit për vlerësim ka këto karakteristika:

1. të jetë sa më shumë objektiv, i sqertë dhe transparent, duke pasur parasysh se qëllimi i vlerësimit është përmirësimi i cilësisë;
2. të jetë krahasim përfundimtar me proceset e përfunduara më parë për vlerësimin e jashtëm të realizuar nga APAAL, të zbatohet analiza e ecurisë në krahasim me mangësitë e konstatuara;
3. të shprehen në mënyrë të qartë anët e forta dhe të dobëta të universitetit dhe t'i shmangët theksimit të anëve pozitive apo mosparaqitjes së anëve negative;
4. anët e forta dhe të dobëta, që nuk janë diskutuar në fillim të raportit duhet të mos publikohen në konkluzione sepse do të mbeten të pa arsyetuara dhe do t'i ndikojnë konkluzionet;
5. anët e forta dhe të dobëta të cilat nuk janë diskutuar në pjesën kryesore të raportit duhet të mos paraqiten as në përfundim;
6. planet për përmirësim të ofrohen në formë të masave konkrete.

Në përfundim të raportit për vetëvlerësim në mënyrë të detyrueshme duhet të parashikohen masat që duhet të ndërmerren sipas rezultateve të vlerësimit.

Neni 43

Madhësia e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë

Madhësia e raportit për vetëvlerësim është prej 20 deri në 40 faqe, pa shtojca.



Neni 44

Nënshkrimi i Raportit të Vlerësimit të Cilësisë

Raportin për vlerësim e nënshkruan Kryetari dhe Specialistët e degës për vlerësim dhe ai i dorëzohet Rektorit të Universitetit dhe Dekanëve të fakulteteve për t'u njohur me të. Raporti dërgohet edhe tek KA për vlerësim edhe në APAAL.

Neni 45

Prafitja e Raportit Pjesmarrësve në Vlerësim

Raporti për vlerësim duhet të jetë në dispozicion të të gjithë anëtarëve që do të marrin pjesë në vlerësim e brendshëm të cilësisë së universitetit si dhe të anëtarëve të KA dhe APAAL.

Neni 46

Publikimi i Raportit të NJBSC

Raporti për vetëvlerësim të SHPAL Pavaresia publikohet në vend të përshtatshëm në faqen elektronike zyrtare të SHPAL Pavaresia.

PJESA E GJASHTË

HYRJA NË FUQI E RREGULLORES

Neni 47

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Senati Akademik dhe nënshkrimi nga ana e Rektorit të SHPAL Pavaresia".



SHKOLLA PRIVATE E ARSIMIT TË LARTË "PAVARËSIA", VLORË

Tel: +355 33 4 11 555

Tel: +355 33 4 11 666

Fax: +355 33 4 11 777



SHKOLLA PRIVATE E ARSIMIT TË LARTË "PAVARËSIA", VLORË

Tel: +355 33 4 11 555

Tel: +355 33 4 11 666

Fax: +355 33 4 11 777



SHKOLLA PRIVATE E ARSIMIT TË LARTË "PAVARËSIA", VLORË

Tel: +355 33 4 11 555

Tel: +355 33 4 11 666

Fax: +355 33 4 11 777